

# MREKULLIA e Himenës NË TEMPULL

**Nga Glenda Mendez de Lopezi**  
(Bazuar në një ngjarje të vërtetë)



*Himena kishte ankth. Por ajo e dinte se Zoti do ta ndihmonte.*

*Kjo ngjarje ndodhi në Guatemalë.*

Himena u fut në makinë dhe shtrëngoi hripin e sigurimit. Ajo dhe prindërit e saj ishin rrugës për në tempull. Kjo do të ishte hera e parë që ajo do të bënte pagëzime në tempull. Papi do ta pagëzonte atë për disa nga paraardhëset e tyre. Himena mezi po priste!

Por pastaj Himena mendoi për diçka që e bëri të ndiente panik brenda vetes. "Papi", – tha ajo "po pompa ime?"

Himena kishte diabet të tipit 1. Për të qëndruar e shëndetshme, ajo gjithmonë mbante

një pajisje të quajtur pompa e insulinës për ta ndihmuar të kontrollonte nivelin e sheqerit në gjakun e saj. Nëse kalonte shumë kohë pa e mbajtur atë, ajo ndihej keq.

"A do të më lejojnë ta mbaj brenda në tempull?", – pyeti Himena. Zemra po i rrihte fort. "Po kur të futem në ujë?"

"Do të shkojë mirë", – i tha Papi. "Mund ta mbash pompën derisa të futesh në ujë. Pastaj Mamá-ja mund të të ndihmojë ta vendosësh përsëri sapo të dalësh nga uji."

Mamá-ja pohoi me kokë. "Dhe nëse fillon të

ndihesh keq ndërkohë që po bën pagëzime, thjesht thuaj Papi-t dhe mund të ndalosh." Mamá-ja ia shtrëngoi dorën fort. "Ne do të jemi me ty gjatë gjithë kohës."

"Në rregull!", – tha Himena. Ajo prapë kishte ankth. Por Mamá-ja dhe Papi e ndihmuan të ndihej pak më mirë.

Kur mbërritën, Himena e kapi Mamá-në dhe Papi-n për dore ndërsa ecnin drejt dyerve të tempullit. Sapo hyri brenda, Himena pati një ndjesi të ngrohtë dhe ngushëlluese. Ajo e dinte se Fryma e Shenjtë po i thoshte që Ati Qiellor do ta ndihmonte, ndonëse kishte ankth. Gjithçka do të shkonte mirë, siç tha Papi.

Himena u ndërrua në veshjet e bardha. Pastaj Mamá-ja e ndihmoi Himenën të hiqte pompën. "Do ta heqësh vetëm për pak minuta", – i tha Mamá-ja. Ajo i dha Himenës një përqaftim.

Himena hyri në ujë. Papi po e priste. Ai i zgjati dorën dhe e ndihmoi të zbriste shkallët.

Papi bëri lutjen e pagëzimit dhe e zhyti Himenën në ujë. Kur doli nga uji, Himena buzëqeshi. Më pas ata bënë edhe disa pagëzime të tjera.

"A ndihesh mirë?", – i pëshpëriti Papi në vesh.

"Po!", – tha Himena.

Papi e pagëzoi edhe për disa njerëz të tjerë. "A mund të bësh të tjera?" – e pyeti ai sërish.

"Po!", – tha Himena.

Pas pagëzimit të fundit, Mamá-ja e ndihmoi Himenën të vendoste pompën dhe i kontrolloi sheqerin në gjak. Mamá-ja buzëqeshi. Niveli i sheqerit ishte normal! Ishte sikur Himena të mos e kishte hequr fare pompën.

Më pas ata shkuan në një dhomë më të vogël. Papi i vuri duart e tij mbi kokën e Himenës. Ai e konfirmoi atë si anëtare të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme për njerëzit e vdekur për të cilët qe pagëzuar ajo. Tani paraardhëset e saj mund të zgjidhnin t'i bashkoheshin Kishës së Jezu Krishtit!

Në mbrëmjen e shtëpisë javën e ardhshme, Himena dhe prindërit e saj biseduan rreth udhëtimit të tyre në tempull. "Tempulli është shtëpia e Zotit", – tha Papi. "Kur shkojmë atje, mund të na ndodhin mrekulli në jetën tonë."

"Çfarë lloj mrekullish?", – pyeti vëllai i vogël i Himenës, Pabloja.

"Unë kisha ankth që do ta hiqja pompën time të insulinës për të hyrë në ujë", – tha Himena. "Por ndërkohë që po bëja pagëzime, nuk u ndjeva aspak e sëmurë. Ishte një mrekulli!", – Himena buzëqeshi. "Ndonëse isha e frikësuar, Fryma e Shenjtë më ndihmoi të ndihesha e qetë. Edhe kjo ishte një mrekulli." ●



ILUSTRIMET NGA ALYSSA PETERSEN

Kur të ka ndihmuar Fryma e Shenjtë që të jesh i/e qetë?